




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	30.12.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-14/14
PËR/ZA/TO:	z. Besnik Jani, Drejtor i Burimeve Njerëzore në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A
CC:	z. Mehdi Latifaj, U.d Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës Sh.A
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Jani,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksioneve publike si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Koordinator i Sektorit për Mbështetje Teknike në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, paraqet papajtueshmëri të funksioneve dhe kufizim në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Besnik Jani – Drejtor Burimeve Njerëzore në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, me numër të protokolit 03-4924/14, në të cilin z. Jani ka kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Raif Çela - Koordinator i Sektorit për Mbështetje Teknike në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, dhe i zgjedhur në funksionin publik si Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me Ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bënë edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në bazë të këtij Ligji neni 4 (paragrafi 2), pozita e Deputetit hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

Lidhur me pyetjen tuaj se a ekziston konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik si Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Koordinator i Sektorit për Mbështetje Teknike në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, Kushtetuta e Kosovës ka paraparë disa kufizime.

Kufizimet e tilla kushtetuta i ka emëruar si papajtueshmëri, të cilat janë vënë me qëllim të sigurimit të pavarësisë së plotë të deputetit dhe ushtrim të paanshëm të funksionit të tij. Kjo si pasojë e asaj se aktivitetet e caktuara jashtëparlamentare, mund të ndikojnë në masë të konsiderueshme në pavarësinë e deputetit. (Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I).

Neni 72 i Kushtetutës parasheh se:

“Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj”.

Bazuar në këtë dispozitë, ushtrimi i njëkohshëm i funksionit të deputetit dhe të qenurit Koordinator i Sektorit për Mbështetje Teknike në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, është i papajtueshëm. Arsyet për këtë janë të sqaruara në paragrafin e mësipërm.

Ndërsa, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, në nenin 16 të tij ka përcaktuar kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit.

Në piken 1 të këtij neni thuhet:

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike, si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit”.

Bazuar në këto dispozita është e qartë se Deputeti i Kuvendit të Kosovës, nuk mund të ushtroj këtë funksion në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, prandaj ju rekomandojmë që të veproni konform këtij opinioni.

Me respekt!

